



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4.4.2025

Nr: 400

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

HEQJEN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NGA ZYRA ZGJEDHORE E
SUBJEKTIT ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, NË DELVINË

Sot më datë 4.4.2025, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin, si më poshtë vijon:

OBJEKTI: Identifikimi i zyrës zgjedhore të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” afër KZAZ-së nr. 89, Bashkia Delvinë, Qarku Vlorë.

BAZA LIGJORE: Neni 19 , pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e 2, të Kodit Zgjedhor, dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J:

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datë 3.4.2025 është administruar raporti i dërguar nga monitoruesi i caktuar në Bashkinë Delvinë, Qarku Vlorë.

Nëpërmjet këtij raporti identifikohet zyra zgjedhore e hapura afër KZAZ-së nr. 89, në distancë më të vogël se 300 m, përkatësisht:

- Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, afër KZAZ-së nr. 89, me vendndodhje Bashkia Delvinë, Qarku Vlorë.

Data: 4.4.2025 Nr: 400
Ora: 10:00



“Për heqjen e materiale propagandistike nga zyra zgjedhore e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në Delvinë”

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, e 2, të kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimin nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S:

1. Urdhërimin e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike nga zyra zgjedhore afër KZAZ-së nr. 89, me vendndodhje në Delvinë, Qarku Vlorë.
2. Urdhërimin e Policisë Bashkiake Delvinë dhe Policisë së Shtetit, të heqin menjëherë materialet propagandistike nga zyra zgjedhore e caktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
3. Ngarkohen subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Policia Bashkiake Delvinë dhe Policia e Shtetit, për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.
4. Ky vendim i njoftohet menjëherë subjektit zgjedhor, Policisë Bashkiake Delvinë dhe Policisë së Shtetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI